



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:224723
Datë: 22.12.2023
Numri i dokumentit: 05110789

C-IV - 15 -1551

Paditësi: A S, Porgorica , Mali i Zi .

Kundër

Të paditurës: NSH „, Shpezëtaria dhe Peshkataria ” , e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. “Driton Hoxha ” nr. 55 , Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 19 dhjetor 2023, mori këtë :

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e paditësit A S, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH „, Shpezëtaria dhe Peshkataria ” PRN 006- 0009, më dt. 18.08. 2015.**
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me dt. 08.09. 2015, pranë DHPGJS, është parashtruar ankesa e paditësit kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH „, Shpezëtaria dhe Peshkataria ” PRN 006-0009, dt. 18.08 2015, me të cilën është refuzuar kërkesa për kompensim të kontributit pensional në shumën e pacaktuar si e pavlefshme .

Në parashtrësë është deklaruar, ankesa ushtrohet për shkak : të cenimit të rregullave të procedurës për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale .

Ka theksuar se ka punuar në NSH „,Shpezërat dhe Blegtori ” në fermën e shpezëve në Gjakovë gjatë periudhës 16.05.1995 deri më dt. 12.06.1999, kur edhe është larguar për shkak të luftës , dhe në firmë në të cilën kam qenë i punësuar më ka mbetur tërë dokumentacioni – dosja personale dhe librezat e punës.

Ka kërkuar që ankesa të aprovohet dhe ti njihet kontributi pensional për periudhën 16.05.1995 deri më dt. 12.06.1999.

Ka bashkangjitur :

- Aktvendimi për caktimin në punë dhe detyra të punës dt. 04.06.1996,
- Vërtetimi dt. 12.06.1999,

- Aktvendimi dt. 14.06.1995
- Vendimi i AL PRN 006- 009 .

Më dt. 22.02.2023, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën në mbrojtje ndaj ankesës së ushtruar kundër Vendimit të AL PRN 006- 0009, me propozim që ajo të refuzohet.

Në parashtrësë është deklaruar se NSH „ Shpezëtaria dhe Peshtaktaria ’, ka hyrë në procedurë të likuidimit, më dt. 03.03.2014. Më dt. 31.03.2014, paditësi ka parashtruar kërkesë për pagimin e kontributeve personale në shumën e pa caktuar .

Më dt. 18.08.2015, AL mori Vendimin PRN 006- 0009, duke refuzuar kërkesën .

Vendimi i AL mbështetet në faktet dhe bazat ligjore :

- i. Neni 36.2.1 i Shtojcës e Ligjit, nr. 04/L-034, parasheh „, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë, dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit ose pronësisë... kërkesa pretendimi është i pasafatëshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme ’’.

Në parashtrësë është deklaruar se AL ka bërë vlerësimin e saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht . Më tej ka theksuar se përkundër kërkesës për kompletimin e dokumentacionit, paditësi ka dështuar të dorëzoi dokumentacionin plotësues, prandaj është refuzuar kërkesa.

Ka bashkangjitur :

- Formularin e kërkesë kreditore,
- Provat të cilat paditësi i ka dorëzuar me ankesë, të konstatuara më lartë.

Më dt. 28.09.2023, DHPGJS ka lëshuar urdhër për paditësin C- IV- 15- 1551, me të cilin i ka kërkuar të deklarohet në parashtrësë të mbrojtjes, pastaj i ka kërkuar të autorizoi një person me adresë në Kosovë për të pranuar shkresat , parashtrësat dhe komunikimin me Gjykatë .

Më dt. 02.11.2023, paditësi e ka pranuar urdhrin .

Arsyetimi Ligjor

Ankesa nuk është e bazuar .

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi procedurën kontestimore, Gjykata nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata nga përmbajtja e ankesës së ushtrua kundër vendimit të AL, PRN 006- 0009, dhe provat e dorëzuara si Aktvendimet dhe vërtetimi , vërtetohet se paditësi kishte punuar në vendin e punës si teknik veterinar, gjatë periudhës së vitit 1995 deri më 12.06.1999, ndërsa për të paditurën si kontestuese është baza e kërkesës .

Gjykatës as paditësi dhe as e paditura nuk i kanë ofruar dëshmi se gjatë periudhës së kërkesës për kompensimin e kontributeve, për dt. 15.05.1995 deri 12.06.1999, sipas të cilës do të vërtetohej fakti se gjatë kësaj periudhe kohore, çka nuk ju është paguar paditësit nga NSH si punëdhënës, gjegjësisht, nuk është dorëzuar prova se paditësit nuk ju janë paguar kontributet pensionale të pretenduara në ankesë.

Gjykata bazuar në provën e formularit të kërkesë kreditore, paditësi nuk e kishte treguar saktë se cila është kërkesa e tij para AL, kështu që AL me kërkesë dt. 13.03.2014, ju ka drejtuar paditësit të plotëson formularin e kërkesës, sa i përket kërkesës dhe të periudhës kohore .

Me nenin 31.5 të Ligjit nr. 06/L-086 është paraparë „ Në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt , ajo palë është e obliguar të paraqesë prova , fizike dhe ose dëshmuese për mbështetjen e atij pohimi ”

Gjykata vlerëson se paditësit ju dha mundësia që me Urdhër C- IV- 15- 1551, dt. 28.09.2023, të deklarohet në kundërshtimet e AKP-së, dhe të dorëzoi prova, por i njëjti nuk është përgjigjur.

Gjykata vlerëson se paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka provuar pretendimet e tija në ankesë kundër vendimit të AL, në kërkesën për kompensimin e kontributit pensional, për periudhën dt. 15.05.1995 deri 12.06.1999, kjo për faktin se kjo kërkesë është si kërkesë e pjesës së pagës bruto dhe paguhet njohësish me pagën mujore, dhe varësisht nga lartësia e pagës mujore paguhet edhe kontributi pensional dhe tatimi në pagë .

Meqenëse paditësi nuk ka dorëzuar prova materiale për mos pagesën e kontributit pensional, gjatë periudhës kontestuese ai nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi të ketë kërkuar në NSH apo të ketë iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore, për kërkesën e tij, para fillimit të procedurës së likuidimit .

Meqenëse paditësi nuk i ka vërtetuar pretendimet e veta faktike dhe juridike në kërkesën e tij, është refuzuar ankesa/kërkesa

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të heqë shpenzimet e veta të procedurës .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva
Gjyqtar